

Tiranë, 27 nëntor 2018

Lënda: Komente për projekt-vendimin “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe përfundimin e Traktatit të Aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”

Në përgjigje të thirrjes së Ministrisë për Evropën dhe Punë të Jashtme drejtuar subjekteve të interesuar, Ju paraqesim më poshtë komentet e Forumit të Politikave të Integritit – EU Policy Hub në lidhje me projekt-vendimin “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe përfundimin e Traktatit të Aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”

A. Konsiderata të përgjithshme për strukturën negociatore të propozuar me Projekt- VKM për “Krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe përfundimin e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”:

1. EU Policy HUB përshëndet nismën e qeverisë Shqiptare për të ndërmarrë hapa konkret në krijimin e strukturës shtetërore përgjegjëse për zhvillimin e negociatave me Bashkimin Evropian. Ky proces është një proces teknik që kërkon ekzistencën e një structure të aftë dhe eficiente si në koordinimin vertical ashtu edhe atë horizontal. Struktura negociatore duhet të jetë e tillë që të qëndrojë mbi preferencat e niveleve të brendshme politike dhe administrative, dhe në gjendje të lidhë në nivele të ndryshme aktor të ndryshëm. Kjo strukturë duhet të jetë në gjendje të identifikojë dhe të mbrojë në nivelin më të lartë interesat kombëtare, duke dalë mbi palët, përtej dallimeve të brendshme politike, si dhe të ndërmarrë masa e veprime të rëndësishme në sektorë të ndryshëm nën presionin e vazhdueshëm të negociatave të gjata me një negociator si Bashkimi Evropian dhe Shtetet Anëtare.
2. Procesi i negociatave me Bashkimin Evropian nuk është një ushtrim i lehtë dhe kjo është e provuar edhe nga proceset e mëparshme të negociimit dhe aderimit të shteteve të Evropës Qëndrore dhe Lindore, apo së fundmi edhe të Kroacisë. Përvojat dhe modelet e mëparshme të strukturave negociatore duhet të shërbëjnë si udhërrëfyes për të shmangur probleme të ngjashme, të cilat burojnë edhe nga ngjashmëria e kontekstit politik dhe ekonomik e vendit me shtetet të cilat u anëtarësuan në valën e katërt dhe të pestë të zgjerimit. Shqipëria, sikundër vendet e tjera post-komuniste që janë anëtarësuar në BE duhet të shmangë politizimin e strukturës negociatore dhe të sigurojë që shërbimi civil funksionon në mënyrë të pavarur. Përfshirja e madhe politike në strukturën negociatore ka efekt negativ në

Forumi i Politikave të Integritit – EU Policy Hub

Forum i profesionistëve të rinj të cilët synojnë të promovojnë, monitorojnë dhe ndikojnë në performancën e procesit të integritit Evropian të Shqipërisë.

www.eupolicyhub.eu info@eupolicyhub.eu

koordinimin e brendshëm të politikave kombëtare, prandaj ajo duhet të preket sa më pak të jetë e mundur nga ndryshimet politike apo koalicionet qeveritare. Për më tepër, efektiviteti i koordinimit të çështjeve të brendshme me politikat dhe kërkesat e BE nuk duhet të shoqërohet me ndryshime të shpeshta të institucioneve të përfshira në koordinim dhe grupe pune. Procesi i negociatave me BE-në zgjat relativisht në kohë dhe nuk arrin të mbyllet brenda një mandati politik 4 vjeçar, çka do të thotë se gjatë procesit të negociatave mund të ketë ndryshime politike. Ndaj dhe për të patur një proces consistent është e nevojshme që struktura bazë për negociatat e sidomos delegacioni shtetëror të jenë rezistent ndaj ndryshimeve politike. **Prandaj, sugjerojmë** arritjen e një marrëveshjeje midis pozitës dhe opozitës për strukturën bazë negociatore dhe përbërjen e Delegacionit Shtetëror. Nga eksperiencia e negociatave të mëparshme të anëtarësimit vihet re se struktura bazë negociatore i ka rezistuar ndryshimeve politike dhe ka patur vetëm lëvizje të vogla në grupin negociator. Madje edhe në rastet kur kanë ndodhur ndryshime në strukturën bazë, këto nuk kanë qënë për arsye politike.

3. Një tjetër sfidë në hartimin e strukturës negociatore është koordinimi efficient dhe pjesëmarrja efektive në hartimin e pozicioneve negociatore. Kjo kërkon jo vetëm një strukturë të mirë menduar, por sikundër tregojnë eksperiencat e mëparshme të zgjerimit, kërkon edhe burime njerëzore të cilat kanë një përvojë dhe ekspertizë të mirë për çështjet evropiane, kapacitet financiar dhe aftësi të mira negocimi. Veçanërisht, është e rëndësishme një njohje shumë e mirë e mekanizmave të punës formal dhe joformal, rregullave të politik-bërjes në Bashkimin Evropian, pa lënë menjëherë aftësitë e mira gjuhësore.
4. Komunikimi me grupet e interesit, me qytetarët, shoqërinë civile, njësitë e qeverisjes vendore, si dhe dialogu dhe përfshirja e Kuvendit janë një tjetër çështje më rëndësi që duhet adresuar. Edhe pse procesi i negociatave është detyrë politike dhe teknike e qeverisë, ai duhet të jetë edhe demokratik i bazuar tek një proces gjithpërfshirës në formulimin e pozicioneve. Përfshirja e këtyre aktorëve, jo vetëm do e bënte procesin më demokratik dhe transparent, por do të siguronte informacion dhe ekspertizë e cila mund ti shërbëjë strukturës negociatore të jetë realiste në negocimin e periudhave tranzitore për adaptimin e *acquis* në kapituj të caktuar. I gjithë procesi i integritit evropian është një proces dinamik i cili kërkon kombinimin e aspekteve politike me ato ligjore dhe teknike, të cilat kërkojnë planifikim strategjik dhe identifikim të prioriteteve dhe interesave kombëtare. Ky proces nga ana tjetër kërkon gjithashtu fleksibilitet dhe përgjigje të shpejta për sfida dhe probleme të ndryshme që dalin gjatë zhvillimeve bilateral dhe multilateral. Për këtë arsye duhet të ketë mekanizma efficientë koordinimi që do të sigurojnë bashkëpunimin e të gjithë partnerëve të interesuar nga njëra anë (sektorit privat, academia, shoqëria civile dhe grupet e interesit), dhe që do të sigurojnë pajtimin e objektivave të brendshëm me kërkesat e BE-së. Prandaj duhet një ndarje më e qartë e përgjegjësisive midis institucioneve të ndryshme të përfshira në procesin e negociimit, krijimi i procedurave dhe standardeve që do të garantojnë një memorie dhe gjurmim të mirë institucional për të gjitha institucionet e përfshira në proces, si edhe kontroll dhe vlerësim i thellë paraprak i pozicionit negociues nga perspektiva e palëve të interesuara.

Forumi i Politikave të Integritit – EU Policy Hub

Forum i profesionistëve të rinj të cilët synojnë të promovojnë, monitorojnë dhe ndikojnë në performancën e procesit të integritit Evropian të Shqipërisë.

www.eupolicyhub.eu info@eupolicyhub.eu

B. Komente specifike:

1. Në Pjesen III (Struktura e Negociatave), Neni 2, propozohet ngritja e Komitetit shtetëror për Integrimin Evropian si organi *“më i lartë që siguron bashkërendimin e qëndrimit politik dhe/ose negociues për secilin kapitull të negociatave, para vendimmarrjes për çështjen përkatëse në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, si dhe kryen funksion mbikëqyrës të çështjeve kryesore në zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit.”* Një organizim të tillë brenda Këshillit të Ministrave e gjejmë edhe në strukturat negociatore të vendeve të tjera si Estonia, Kroacia apo Serbia. Edhe në këto vende pranë qeverisë është krijuar një njësi e përbërë nga ministrat kryesorë me qëllim koordinimin e procesit. Në pikën III.2 propozohen si anëtarë të përhershëm në KSHIE disa ministra. Ndër ta, nuk figuron ministri/a përgjegjës/e për ekonominë. Ndonëse në strukturën e tanishme të Këshillit të Ministrave, ministri përgjegjës për financat është njëherazi përgjegjës edhe për ekonominë, kjo strukturë nuk do të mbetet medoemos e pandryshuar në periudhën jatë negociatave për anëtarësimin. Andaj, duke pasur parasysh rëndësinë e çështjeve të lidhura me ekonominë dhe tregun e përbashkët gjatë zhvillimit të negociatave mbi kapitujt e “acquis”-it dhe, tek e fundit, për vete ekzistencën e Bashkimit Evropian, gjykojmë së përfshirja e ministrit/es përgjegjës/e për ekonominë si anëtar/e i/e përhershëm/me në KSHIE është diçka e domosdoshme.
2. Pika III.5 parashikon që *“Komiteti Shtetëror për Integrimin Evropian i dërgon për mendim Këshillit Kombëtar për Integrimin Evropian, qëndrimin politik dhe/ose qëndrimin negociues për secilin kapitull të negociatave të dakordësuar, para miratimit të tij me Vendim të posaçëm të Këshillit të Ministrave.”* Në këtë parashikim thuhet vetëm që KSHIE i dërkon KKIE për mendim pozicionin, por nuk parashikohet asgjë lidhur me vlerën dhe fuqinë e mendimit/opinionit të KKIE. A mund të paraqesë KKIE propozime, amendamente? Do të jetë kjo një procedurë konsultative, apo mendimi i Këshillit Kombëtar për Integrimin Evropian do të ketë fuqi detyruese? Në çdo rast, duhet të përcaktohen afate dhe procedura sa kohë përpara duhet cuar qëndrimi politik dhe negociues për mendim para Këshillit Kombëtar për Integrimin Evropian, si edhe afatet dhe procedurat e përcjelljes së këtij opinion nga Këshilli Kombëtar për IE tek Komiteti Shtetëror për IE. Duke qënë se Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian përbëhet nga përfaqësues nga parti të ndryshme politike, duhet të sigurohet që situatat politike mos të prodhojnë ndërime në miratimin e pozicioneve negociuese apo politike.
3. Pika III.6 parashikon që *“Komiteti Shtetëror për Integrimin Evropian mbledhet jo më pak se një herë në tre muaj dhe sa herë që është e nevojshme, për të diskutuar çështjet që parashikon kalendari i mbledhjes, i miratuar nga Kryeministri, me propozimin e Kryetarit të Delegacionit Shtetëror.”* Në projekt-Vendim KSHIE ka rol të rëndësishëm në formulimin e pozicioneve negociatore dhe mbledhja një herë në tre muaj mund të sjellë problem në avancimin e pozicionit. Po ti referohemi modeleve të strukturave negociatore të vendeve të anëtarësuar më parë, mbledhjet koordinuese në nivel ministrash kanë qënë të përjavshme për të diskutuar mbi çështjet evropiane. Sërish, duke patur në konsideratë që mund të ketë edhe qeveri koalicionesh e të ketë mosmarrëveshje midis Kryeministrit

Forumi i Politikave të Integritimit – EU Policy Hub

Forum i profesionistëve të rinj të cilët synojnë të promovojnë, monitorojnë dhe ndikojnë në performancën e procesit të integritimit Evropian të Shqipërisë.

www.eupolicyhub.eu info@eupolicyhub.eu

dhe Ministrit për integrimin Evropian (kryetarin e Delegacionit), propozojmë që të shtohet që mbledhja mund të thërritet edhe me propozim të Kryenegociatorit, ose të gjendet një formulë ku një/disa aktorë mund të thërrasin mbledhjen kur kjo është e nevojshme. Struktura negociatore duhet të jetë e tillë që mundëson marrjen e vendimeve të shpejta, bazuar në ekspertizë të shëndësoshë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në fazën e fundit të procesit të negociatave, sidomos në konferencën e fundit ndërqeveritare.

4. Sipas pikës IV. 2 Delegacioni Shtetëror përbëhet nga: a) Ministri përgjegjës për çështjet e integritit evropian dhe punët e jashtme në funksionin e Kryetarit të Delegacionit Shtetëror; b) Zëvendëskryetari i Delegacionit Shtetëror – Kryenegociatori; c) Kreu i Misionit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian; d) Përfaqësues të ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore, sipas rastit.

Rregullimi i përgjegjësisë të misioneve diplomatike bëhet me Ligji Nr. 9095 “Për Shërbimin e Jashtëm në Republikën e Shqipërisë.”¹ Përgjegjësia e misioneve diplomatike apo kreve të misioneve diplomatike nuk mund të ndryshohet me VKM. Ligji Nr. 9095 “Për Shërbimin e Jashtëm në Republikën e Shqipërisë” parashikon cilat janë funksionet e kreut të misionit diplomatik dhe në nenin 28 pika 2 parashikon që “ *Kreu i misionit diplomatik kryen funksione dhe veprimtari të tjera, për të cilat autorizohet nga Ministri i Punëve të Jashtme në përputhje me legjislacionin në fuqi.*” Pra, veprimtaritë e Kreut të Misionit të Shqipërisë në BE janë vetëm ato që përcakton Ligji Nr. 9095 “Për Shërbimin e Jashtëm në Republikën e Shqipërisë” apo autorizohen nga Ministri i Punëve të Jashtme, por këto funksione nuk mund të ndryshohen apo jepen me VKM.

5. Nuk është e qartë marrëdhënia e Komitetit Shtetëror për IE me Delegacionin Shtetëror. A është Delegacioni vetëm “zëdhënës” i vendimeve të KSHIE në Bruksel, apo Delegacioni ka edhe ndonjë rol në zhvillimin, përmirësimin e pozicioneve politike dhe negociuese? Pas zhvillimeve të takimeve në Bruksel dhe konferencave ndërqeveritare bilaterale a duhet të raportojë Delegacioni para Komitetit Shtetëror për IE? Duhet të vendosen afate dhe procedura për këtë raportim, ose një takim i përbashkët i Delegacionit me KSHIE lidhur me zhvillimet dhe dialogun me Bashkimin Evropian.
6. Nuk është i qartë cili është raporti i varësisë midis Sekretariatit të Integritit Evropian dhe MEPJ dhe mënyra se si do të bashkëpunojnë këto dy struktura për të shmangur rivalitete dhe konflikte të mundshme.
7. Pika V.2 “*Kryenegociatori dhe anëtarët e Grupit negociator emërohen me urdhër të Kryeministrit.*” Kryenegociatori është një nga aktorët kyc në procesin e negociatave. Edhe në projekt- VKM kryenegociatori zë një pozicion të veçantë pasi është pjesë e KSHIE dhe Delegacionit Shtetëror si dhe drejton grupin negociator dhe Sekretariatin. Për hir të peshës dhe volumit të punës si edhe vazhdueshmërisë së procesit është e udhës që ky pozicion të ketë garanci procedurale që të mos zevëndsohet apo hiqet lehtësisht. Ky pozicion nuk duhet të jetë i prekshëm nga situatë politike në vend, nga ndryshimi i

¹Ligj, Nr.9095 “Për Shërbimin e Jashtëm në Republikën e Shqipërisë.” datw 03.07.2003, Flet.Zyrtare Nr.64, Faqe:2854

qeverive, por i lidhur ngushtësisht me procesin e punës dhe përgatitjen e pozicioneve teknike. Arsyet e shkarkimit të tij duhet të lidhen me efektivitetin dhe eficiencën në koordinimin e punës dhe jo me vullnetin politik të ekzekutivit.

8. Nuk ka një parashikim nga rradhët e kujt do të zgjidhet Kryenegociatori. Nuk është e qartë nëse kryenegociatori do të jetë person me status nënpunësi civil apo diplomat apo ekspert jashtë rradhëve të administratës publike. Po kështu nuk ka një parashikim për shkollimin/përvojën profesionale/cilësitë/aftësitë.
9. Është e rëndësishme të përcaktohet marrëdhënia e Kryenegociatorit me Ministrin e Punëve të Jashtme dhe Integritimit Evropian. Në raste konflikti apo rivaliteti midis tyre mund të krijohen problem të cilat prekin legjitimitetin dhe pozicionin e Kryenegociatorit. Përshembull në rastin e Serbisë, ka qënë një problem serioz marrëdhënia e Ministrin pa portofol për integrimin evropian dhe zyrës së Kryenegociatorin, e cila çoi në ndryshimin e strukturës paraprake që krijonte rivalitet midis këtyre dy aktorëve.
10. Duke qënë se kryenegociatori në këtë projekt-Vendim është i ngarkuar me shumë përgjegjësi dhe vesh disa “role”, ka rrezik që performanca dhe efienca e tij të ulet. Për të asistuar kryenegociatorin në përmbushjen e të gjithë veprimtarisë që i ka dhënë Projekt-VKM, propozojmë që Kryenegociatori të ketë 1 deri në 2 zëvendës-kryenegociator, apo Zyrën e Sekretariatit me ekspertë që do lehtësojnë kryerjen e funksioneve të tij, përshembull si në rastin e Kroacisë.
11. Nuk është i qartë raporti i Pikës V.2 me V7. Në pikën V.2 thuhet se “ Grupi Negociator drejtohet nga Kryenegociatori, dhe përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë. *Kryenegociatori dhe anëtarët e Grupit negociator emërohen me urdhër të Kryeministrit.*” ndërsa në pikën V.7. thuhet se “ Përbërja e Grupit Negociator, përgjegjësitë e anëtarëve, si dhe rregullat e funksionimit të tij miratohen me Urdhër të Kryeministrit, me propozim të Kryetarit të Delegacionit Shtetëror.” Anëtarët e grupit negociator dhe përbërja e grupit negociator janë e njëjta gjë? A do të miratohen ata vetëm me urdhër të kryeministrit apo gjithmonë me propozim të Kryetarit të Delegacionit Shtetëror? Çfarë ndodh nëse Kryeministri nuk është dakord me propozimet e Kryetarit të Delegacionit Shtetëror, a mund të vendos të emërojë vet, apo duhet të qëndrojë brenda listës së propozuar nga Kryetari i Delegacionit? A do të këshillohet apo marrë mendim Kryeministri nga Kryetari i Delegacionit edhe për emërimin e Kryenegociatorit?
12. Përfshirja e ekspertëve të jashtëm në grupin negociator dhe në sekretariatit e integritimit evropian. Nga përvojat e anëtarësimit të shteteve të tjera, rezulton se një nga problemet e strukturës negociatore është mungesa e burimeve njerëzore. Procesi i negociimit është i gjatë, teknik, i shpejtë dhe kjo ngarkesë nuk mund të përballohet vetëm me kapacitetet e administratës publike. Kështu p.sh. në Kroaci në grupin negociator krahas nënpunësve civil u përfshinë edhe ekspertë të jashtëm nga academia dhe Dhoma Kroate e Tregtisë. Sekretariati teknik është një organ shumë i rëndësishëm në procesin e negociimit. Krahas detyrave koordinuese dhe menaxhuese ai ka si përgjegjësi të përgatisë projekt-

Forumi i Politikave të Integritimit – EU Policy Hub

Forum i profesionistëve të rinj të cilët synojnë të promovojnë, monitorojnë dhe ndikojnë në performancën e procesit të integritimit Evropian të Shqipërisë.

www.eupolicyhub.eu info@eupolicyhub.eu

propozimet për qëndrimet negociuese për çdo kapitull të “*acquis*” të Bashkimit Evropian, mbështetur në projekt-propozimet e qëndrimeve negociuese të hartuara nga secili Grup Ndër-Institucional Pune siç përcaktohet në seksionin VIII të këtij vendimi.” Duke patur në konsideratë që çështjet dhe gjuha teknike e Bashkimit Evropian është shumë specifike propozojmë që në përbërje të tij krahas nëpunësve të ministrisë së jashtme të ketë edhe ekspertë të jashtëm. Ekspertët e jashtë sugjerohet të jenë persona me një profil shumë të mirë në njohjen e politikave dhe politik-bërjes në BE dhe që do të asistojnë në hartimin e pozicioneve negociuese.

13. Duhet të parashikohen rregulla më të qarta për koordinimin dhe ndërveprimin e institucioneve të ndryshme të strukturës negociatore me njëri-tjetrin. Duhet të ketë parashikime për llogaridhënien dhe si do të zgjidhen konfliktet apo ngërçet midis grupeve ndër-institucionale të punës, grupeve të punës dhe sekretariatit etj. Struktura e zgjedhur negociatore nga parashikimet kryesore duket një strukturë e centralizuar tek KSHIE dhe Këshillimi i Ministrave. Ekzistenca e një structure negociatore të centralizuar ka avantazhin që në rast konfliktesh midis ministrish apo departamentesh, ndërhyr strukturë qëndrore koordinuese duke marrë vendime dhe duke e bërë të detyrueshëm pajtimin e qëndrimeve. Në draftin e paraqitur ekzistojnë organe që do të lehtësojnë koordinimin midis grupeve ndër-institucionale të punës siç është sekretariati apo grupi negociator, megjithatë nuk është e qartë cili do ta luaj rolin e strukturës qëndrore koordinuese që ka autoritetin vendimmarrës të zgjidhë konfliktet potenciale midis ministrive dhe departamenteve si edhe mënyra/procedura se si do të realizohet kjo.
14. Projekt-vendimi nuk parashikon cili do të jetë roli i Parlamentit përgjatë negociatave, i cili është një institucion që garanton vazhdimësi edhe nëse ndryshon qeveria. Për shembull, Serbia parashikon që Qeveria të paraqesë propozimin e pozicionit negociues tek organi kompetent i Parlamentit. Organi kompetent i Parlamentit pasi shqyrton pozicionin negociues mund edhe të ftojë në seancë përfaqësuesit e Qeverisë, anëtarin kompetent të Qeverisë, Kryetarin e Grupit Negociues dhe Shefin e Ekipit Negociator, ose një anëtar të Ekipit Negociator të emëruar nga Shefi i Ekipit Negociator.
15. Gjatë procesit të negociatave, pasi arrihen piketet hyrëse dhe mbyllëse (opening/ closing benchmark) dhe pasi është arritur një marrëveshje midis BE dhe vendit kandidat për kapitullin e negociimit, ky kapitull mbyllet përkohësisht. Nga përvoja e negociimit të vendeve të tjera, është konstatuar se nga hapja deri në mbyllje të një kapitulli kalon kohë dhe gjatë kësaj periudhe nëse nuk plotësohen dhe mbikqyren siç duhet piketat dhe detyrimet e ndërmarra për kapitujt respektivë, këta kapituj negociimi mund të rihapen. Në projekt vendim ka parashikime për mbikqyrjen e MSA dhe dokumenteve strategjike por jo të pozicioneve negociuese. Nuk është e qartë cili institucion do të monitorojë zbatimin e angazhimeve të marra në pozicionet negociuese, piketat e hapjes dhe mbylljes (opening and closing benchmark). Është e nevojshme të përcaktohet cili do të mbikqyrë plotësimin e detyrimeve të ndërmarra gjatë procesit të negociimit. I njëjti sistem monitorimi duhet të ekzistojë edhe për periudhën kur mbyllet

Forumi i Politikave të Integritimit – EU Policy Hub

Forum i profesionistëve të rinj të cilët synojnë të promovojnë, monitorojnë dhe ndikojnë në performancën e procesit të integritimit Evropian të Shqipërisë.

www.eupolicyhub.eu info@eupolicyhub.eu

negociatat si dhe para aderimit në BE. Komision do të monitorojë ngushtësisht të gjitha angazhimet e ndërmarra dhe duhet jo vetëm një koordinimi shumë i mirë në prezantimin e pozicionit kombëtar, por gjithashtu edhe raportim dhe prova të shëndosha për rekordin e plotësimit të detyrave të vendosura nga Komisioni në raportet screening dhe piktetat.

16. Në Projekt Vendim nuk është rregulluar çështja e publicitetit të pozicioneve negociuese. Kjo është një pikë delicate dhe ka modele të ndryshme të ndjekura nga vendet e anëtarësuara më parë. Vende si Sllovenia, Republika Çeke dhe Sllovakia i publikonin pozicionet e tyre negociuese të plota. Në Estoni përmbajtja e pozicionit negociues nuk publikohej, ndërsa në Hungari publikohej vetëm pasi ishte dorëzuar pozicioni. Në parim, qytetarët kanë të drejtën e informimit. Publikimi i pozicioneve negociuese i shërben të drejtës së informimit dhe e bën procesin më transparent. Sygjerohet që të mbahet një balancë e drejtë midis nevojës dhe të drejtës së qytetarëve për tu informuar për pozicionin negociator dhe atyre rasteve kur publikimi i këtij pozicioni mund të dëmtojë rezultatet e negociatave.
17. Projekt-vendimi nuk parashkon se cili/cilët do të jenë institucionet që do të mbulojnë shpenzimet financiare për zbatimin e vendimit.
18. Projekt-vendimi nuk parashkon një rol të rëndësishëm të Shoqërisë Civile. Rekomandohet që SHC duhet të përfaqësohet me të paktën një antarë në struktura të tilla si Delegacioni Shtetëror, Grupi Negociator, Sekretariati i Integritimit Evropian, dhe Grupet Ndër-institucionale të Punës. Për shembull, Serbia parashikon që Këshillit Koordinues duhet të përbëhet nga një përfaqësues i Zyrës së Bashkëpunimit të Shoqërisë Civile. Projekt-vendimi duhet t'u mundësojë përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile që të vizitojnë institucionet e BE-së dhe të marrin pjesë pa kosto në negociata dhe konferenca të organizuara nga BE lidhur me negociatat.
19. Përsa i përket rolit të shoqërisë civile, në pamje të para duket se ka një përfshirje të saj në “Platformën për Partneritetin e Integritimit Evropian” në pikën f) cka e bën procesin më transparent, të aksesueshëm dhe të hapur për të gjithë shoqërinë dhe vendos një bazë konstante për dialogun midis qeverisë dhe shoqërisë civile. Ne e vlerësojmë faktin se përfshirja e shoqërisë civile në procesin e negocimit është bërë për të gjithë fushat e acquis, në përputhje me fushën e ekspertizës. Gjithsesi, lidhur me përfshirjen e shoqërisë civile në këtë strukturë kemi këto observime:
 - (i) Platforma e Partnershipit për IE është një strukturë ad hoc, e krijuar me qëllimin për të “informuar, konsultuar, komunikuar me shoqërinë civile, akademinë, palët e interesuara, organet e qeverisjes vendore lidhur me procesin e anëtarësimit.” Duhet përmendur se misioni i kësaj platforme përkon dhe mbivendoset me misionin dhe qëllimet e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile, i cili është një tjetër strukturë mikse shoqëri civile- qeveri, dhe e cila ka një përvojë dhe rekord të funksionimit dhe mbledhjes së ideve dhe opinioneve për çështje të lidhura me përfshirjen e shoqërisë

Forumi i Politikave të Integritimit – EU Policy Hub

Forum i profesionistëve të rinj të cilët synojnë të promovojnë, monitorojnë dhe ndikojnë në performancën e procesit të integritimit Evropian të Shqipërisë.

www.eupolicyhub.eu info@eupolicyhub.eu

- civile në vendimmarrjen kombëtare. Edhe pse projekt vendimi parashikon se funksionimi dhe organizimi i “Platformës” do të miratohet me udhër të Ministrit përgjegjës për çështjet e BE, është për tu diskutuar krijimi i kësaj platforme e cila mund të dublikojë një strukturë tashmë ekzistuese dhe të mbulojë të njëjtat funksione, me korrigjime të vogla dhe duke u mbështetur në eksperiencën e koordinimit dhe aftësive vendimmarrëse që tashmë janë krijuar. Për rrjedhojë theksohet se projekt vendimi nuk parashikon komunikim të mjaftueshëm për të mundësuar strukturën e re negociatore për të koordinuar strukturën tjetër ekzistuese (Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile) të krijuar për të mbështetur pjesëmarrjen e shoqërisë civile në vendimmarrje, me kapacitetin e vëzhguesit si dhe mbështetësit të procesit të aderimit të Shqipërisë në BE.
- (ii) Eksperienca e Malit të Zi për ngritjen dhe funksionimin e strukturës negociatore tregon se një mënyrë efektive për përfshirjen e drejtpërdrejtë të shoqërisë civile në procesin e anëtarësimit në BE është nëpërmjet përfshirjes së tyre drejtpërdrejtë në grupet ndër-institucionale të punës, e jo si një platformë *ad hoc* dhe të veçuar. Do të këshillojmë që në përbërjen e grupeve të punës të krijohet mundësia për një pjesëmarrje aktive e aktorëve të shoqërisë civile si ekspertë të pavarur, academia, grupet e biznesit, organizata sindikalistësh, etj.
 - (iii) Përfshirja e shoqërisë civile në grupet e punës apo në “Platformë” duhet të bazohet në një proces të hapur dhe publik që do të mundësojë koordinimin midis institucioneve shtetërore dhe organizatave të shoqërisë civile. Në këtë rast, Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile duhet të jetë në ngarkim të shqyrtimit të kandidatëve, bazuar në ekspertizë dhe nivelin e përfaqësimit. Përfaqësuesit e shoqërisë civile duhet të jenë në përbërje të grupeve të punës. Si shëmbull mund të marrim vende si Mali i Zi ku në 33 grupet e punës kishte 958 anëtarë nga qeveria dhe 344 përfaqësues nga shoqëria civile^[1]. Nëpërmjet përfshirjes në grupet e punës, shoqëria civile do të ketë më shumë kuptim dhe informacion lidhur me procesin dhe më shumë mundësi për kontribut.
 - (iv) Shoqëria civile si pjesë e grupeve të punës duhet jo vetëm të kërkojë informacion lidhur me procesin e aderimit, por edhe të jetë në gjendje të diskutojë publikisht propozimet dhe sugjerimet e bëra. Në këtë kuadër është e rëndësishme që pikëpamjet dhe vlerësimet për çdo kapitull të bëhen publike dhe të identifikohen qartë në rregullat e procedurës së grupit ndër-institucional të punës. Ky rregullim është *“veçanërisht i rëndësishëm nëse kemi në konsideratë përpjeket që janë bërë përfaqësuesve të shoqërisë civile në Malin e Zi me Rregullat e Procedurës së grupeve të punës.”*^[2]

^[1] Nikolovski, I. (September 2018), “Macedonia’s model of inclusions of CSOs in the accession negotiations” Discussion paper No.16/2018, Konrad Adenauer Foundation, p. 4

^[2] http://cep.org.rs/images/background_paper_coordination_requirements_in_eu_accession.pdf

Forumi i Politikave të Integritimit – EU Policy Hub

Forum i profesionistëve të rinj të cilët synojnë të promovojnë, monitorojnë dhe ndikojnë në performancën e procesit të integritimit Evropian të Shqipërisë.

www.eupolicyhub.eu info@eupolicyhub.eu